

KONTRATË THEMELIMI
15 Mars 2023

MIDIS

Z. ARMAND TRAGAJ

DHE

Znj. XHESIDA TRAGAJ
Z. ARTUR CANALIU

Për krijimin e Shoqërsë së thjeshtë
“AXTA TECHNOLOGY”

E cila themelohet si entitet, bazuar nenet 1074 e vijues të Kreut XXII të Kodit Civil për Shoqërinë e Thjeshtë.

Indeksi

- Palët kontaktore.
- Qëllimi dhe objektivat.
- Neni 1. Forma ligjore e Shoqërisë.
- Neni 2. Emri, Sigla dhe Simboli.
- Neni 3. Burimet financiare.
- Neni 4. Qëllimi i Shoqërisë.
- Neni 5. Objekti i Veprimtarisë.
- Neni 6. Partneriteti dhe interesat anëtarëve themelues.
- Neni 7. Garancite ligjore.
- Neni 8. Deyrimet e anëtarëve.
- Neni 9. Organet drejtuese të shoqërisë.
- Neni 10. Punësimi.
- Neni 11. Sekreti tregtar.
- Neni 12. Partneriteti me palë të treta.
- Neni 13. Mbarimi i Shoqërisë.
- Neni 14. Mosmarveshjet.
- Neni 15. Te drejtat e lidhura me emërin e shoqërisë.
- Neni 16. Njoftimi.
- Neni 17. Dispozitë kalimtare.

**KONTRATË THEMELIMI
PËR SHOQËRINË E THJESHTË “AXTA TECHNOLOGY”**

Sot më datë 15 Mars 2023, Anëtarët Themelues:

1. **Z. ARMAND TRAGAJ**, Atësia Luftar, Amësia Luljeta, i datëlindjes, 07.02.1987, shtetas Shqiptar, lindur në Durrës dhe banues në Durrës, me adresë Nail Kondi 00690567; Nd. 22; H. 1. Madhor dhe me zotësi të plotë juridike, mbajtës i letërnjoftimit ID 034143284/I70207061O me afat deri më datë 09.03.2025
2. **Znj. XHESIDA TRAGAJ**, atësia Lulzim, amësia Flora, e datëlindjes 29.10.1992, shtetase Shqiptare, lindur në Maminas, Durrës dhe banuese në Durrës, me adresë Nail Kondi 00690567; Nd. 22; H. 1; Durres. Madhore dhe me zotësi të plotë juridike, mbajtëse e letërnjoftimit ID 032742558/J26029009K me afat deri më datë 08.03.2025.
3. **Z. ARTUR CANALIU**, atësia Lulzim, amësia Flora, i datëlindjes 12.09.1996 shtetas Shqiptar, lindur në Maminas, Durrës dhe banues në Shijak/Durrës, me adresë Vlashaj 00810095; Nd. 36; H. 1; Maminas; Vlashaj. Madhor dhe me zotësi të plotë juridike, mbajtës i letërnjoftimit ID 032744130/J60912016T me afat deri me date 09.03.2025.

Të tre së bashku me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, të shprehur nëpërmjet kësaj kontrate themelimi bien dakort për krijimin e shoqëris së thjeshtë për ndërtimin e një objekti industrial dhe përdorimin e tijë për nevojat e vetë shoqëris.

Duke patur parasysh që:

- A. **Z.Armand Tragaj**, është pronar i ligjshëm i paursive nr. 159/154 dhe 159/162 të ndodhura në zonën kadastrale nr 2574 pasuri të përfituara si familje buqësore bazuar në ligjin nr. 7501 datë 19.7.1991 “Për Token”. Në këto pasuri është investuar duke e kthyer nga tokë arë në truall dhe është paisur me leje ndërtimi duke e paguar dhe detyrimet përkatëse të përcaktuara në vendimin e lejes së ndërtimit Nr. 13464-21/2 Prot. miratuar me Vendimin Nr. 2794, date 02/02/2022.
- B. **Znj. Xhesida Tragaj dhe z.Artur Canaliu**, janë bashkpronarë të ligjshëm të pasuris nr 333/14 e ndodhur në zonën kadastrale 3796, e përfitur në me kontratë dhurimi prej familjarët e tyre.
- C. Palet bien dakort që pasurit nr. 159/154 dhe 159/162 të ndodhura në zonën kadastrale nr 2574 të shiten, dhe të ardhurat e përfituara nga shitja të investohen në pasurinë nr 333/14 e ndodhur në zonën kadastrale 3796, për ndërtimin e një objekti industrial, që dp to shërbejë objektit të veprimtaris tregtare të vetë shoqëris.
- D. Palet i konfirmojnë marreveshjen sipas pikave të renditura në vijim dhe bien dakord që, si subjekt të termave të kësaj marreveshje ato deshirojnë të krijojnë një shoqëri të thjeshtë, siç specifikohet në Nenin 1, e cila do të zhvillojë projektin drejtpërdrejt dhe/ose nëpërmjet nënkontraktimeve më shoqëri të tjera dhe më pas do ta shfrytëzojë sipas objektit të veprimtaris. Palët dëshirojnë të hyjnë në këtë Marreveshje për të vendosur dhe përcaktuar të drejtat e tyre përkatëse, interesat dhe detyrimet për sa i takon pjesëmarrjes së tyre të përbashkët në Projekt Pra, palët bien dakord për sa viion:

Neni 1 Forma ligjore e Shoqërisë

- 1.1. Forma e kësaj shoqërie është “Shoqëri e thjeshtë” në mbështetje të neneve 1074 e vijues të Kreut XXII të Kodit Civil për Shoqërinë e Thjeshtë.
- 1.2. Shoqëria e thjeshtë “AXTA TECHNOLOGY” themelohet si entitet, bazuar në:
 - a) Ligjin Nr.8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës Së Shqipërisë” (ndryshuar me ligjet nr. 8431, datë 14.12.1998; nr. 8491, datë 27.5.1999; nr. 8535, datë 18.10.1999; nr. 8812, datë 17.5.2001; nr. 9062, datë 8.5.2003; nr. 9953, datë 14.7.2008, nr.10 052, datë 29.12.2008, nr. 49/2012, datë 19.4.2012; 122/2013, datë 18.4.2013; 160/2013, datë 17.10.2013; nr. 114/2016, datë 3.11.2016; nr. 38/2017, 30.3.2017) dhe Vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.11, datë 5.4.2013.
 - b) Ligjin Nr.9723, Datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”
- 1.3. Shoqëria e thjeshtë “AXTA TECHNOLOGY” është Person Juridik Privat. Selia e saj ndodhet në pasurinë 333/14 e ndodhur në zonën kadastrale 3796, fshati Vlashaj, njësia administrative Maminas Durrës.

Neni 2 Emri, Sigla dhe Simboli

- 2.1. Shoqëria ka emrin, vulën, logon dhe faqen e saj të internetit të cilat janë pjesë përbërëse e shoqërisë.
- 2.2. Emri, dhe logo e shoqërisë duhet të figurojnë në të gjithë shkresat, komunikimet elektronike, reklamat, si dhe në cdo veprimtari tjetër që cmohet e nevojshme nga administratori.
- 2.3. Emri i shoqërisë është “AXTA TECHNOLOGY”.
- 2.4. Logo e shoqërisë është e përbërë nga tre ingranazhe” të ndërthurura me njëra-tjetrën dhe me shkrimin “AXTA TECHNOLOGY”. Ngjyra ingranazheve është si ajo e oksidit të bakrit dhe ngjyra e shkrimit është e zezë. Logo pasqyrohet konkretisht si më poshtë:



- 2.5. Vula e shoqërisë është e njëjtë me logon
- 2.6. Emri dhe logo e shoqërisë janë të drejta të cilat mund të përdoren vetëm me miratimin e asamblesë të kësaj shoqërie.

Neni 3 Burimet financiare

- 3.1. Kapitali themeltar i Shoqërisë është i përbërë nga kontributi i Anëtarëve Themelues në vlerën 100,000 Lekë.
- 3.2. Kapitali themeltar është investuar nga Anëtarët Themelues në gjithë madhësinë e tij dhe në këtë mënyrë:

- I. Armand Tragaj në masën 50 000 lek.
II. Xhesida Tragaj në masën 25 000 lek.
III. Artur Canaliu në masën 25 000 lek.
- 3.3. Vlerësimi kapitalit themeltar është bërë nga Anëtarët Themelues me rastin miratimit të kësaj Kontrate Themelimi dhe është nënshkruar prej tyre. Vleftësimi i mëtejshëm i kapitalit themeltar nuk lejohet.
- 3.4. Znj. Xhesida Tragaj dhe Z. Artur Canaliu, vë në dispozicion të shoqëris një sipërfaqë prej 5383,02 m² tokë arë me të dhënat e me poshtme Numri i Pasurisë 333/14, Kodi Unik 3796002002, Zona Kadastrale 3796. Kjo pronë do të shërbej si truall mbi të cilin do të bëhet investimi i parashikuar për ndërtimin e një objekti industrial sipas specifikimeve që do të miratohen në lejen e ndërtimit. Pasuria e sipërpërmendur do të regjistrohet të emër të shoqëris. Aplikimi për leje zhvillimi dhe leje ndërtimi do të bëhet prej shoqëris.
- 3.5. Z. Armand Tragaj, vë në dispozicion të shoqëris burime financiare për ndërtimin e një objekti industrial sipas specifikimeve që do të miratohen në lejen e ndërtimit. Me përfundimin e procedurave të shitblerjes së paursive nr. 159/154 dhe 159/162 të ndodhura në zonën kadastrale nr 2574, të gjitha të ardhurat e përfituara nga ky transaksionit do të depozitohen në llogarin e shoqëris.
- 3.6. Vlera i investuar për ndërtimi meret e mirqenë nga palët se është e barabartë me truallin.
- 3.7. Me ndërtimin objektit palëve i lind e drejta dhe bëhen bashkë pronar në pjesë ideale dhe të pandarë në këtë mënyrë.
I. Armand Tragaj në masën 50 % të sipërfaqës ose 1/2 pjesë.
II. Xhesida Tragaj në masën 25 % të sipërfaqës ose 1/4 pjesë.
III. Artur Canaliu në masën 25 % të sipërfaqës ose 1/4 pjesë.
- 3.8. Pas ndërtimit të objektit dhe gjatë ushtrimit të aktivitetit fitimet dhe humbjet e kësaj veprimtarie ekonomike do të ndahen midis anëtarëve në fund të vitit duke u përcaktuar kjo shumë me vendim të asamblesë. Me vendim të asamblesë do të përcaktohet kontributi i cdo antari dhe në varësi të këtij kontributi do të bëhet ndarja e fitimit apo humbjes. Fitimi është lirisht i transferueshëm brënda edhe jashtë shtetit shqiptar.

Neni 4 Qëllimi i Shoqërisë

- 4.1 Veprimtari ekonomike me qëllim fitimi.
- 4.2 Shoqëria ka të depozituar në Bankën "Cerdins" me seli në Durrës, kapitalin në të holla, i cili depozitohet në llogarinë e "AXTA TECHNOLOGY" në datën e nënshkrimit të kësaj Kontratë Themelimi.
- 4.3 Mbas rregjistrimit të Shoqërisë kjo shumë do të kalojë në llogarinë e kësaj shoqërie që do të çelet pranë Bankës "Credins".

Neni 5 Objekti i Veprimtarisë

Shoqëria e thjeshte "AXTA TECHNOLOGY" do të ketë si objekt të veprimtarisë së saj:

- I. Import, eksport dhe tregtimin e paisjeve teknologjike
II. Import, eksport dhe tregtimin e programeve teknologjike.

Neni 6 Partneriteti dhe interesat anëtarëve themelues

Anëtarët Themelues mund të heqin dorë nga anëtariteti por gjithnjë për shkaqe të përligjura. Heqja dorë nuk e shkarkon anëtarin, që heqë dorë nga detyrimet e Shoqëris deri në momentin e heqjes dore.

Asnjëra nga Palet nuk mund të shesë, transferoje, të emërojë, lërë peng, ose të kalojë në ndonjë formë tjetër një pjesë ose të gjithë interesin e saj ne Shogerinë e Thjeshtë, pa patur më parë një pelqim me shkrim nga Pala tjetër, të cilës i njihet dhe e drejta e parablerjes.

Ne rast se cilado Pale shet, transferon, emëron apo lë peng interesa të saj në një filial apo një kompani të lidhur. Pelqimi nuk duhet të refuzohet në menyre të paarsyeshme, nëse këto të fundit ngjallin besim dhe siguri për përmbushjet e detyrimeve të tyre të ardhshme.

6

Neni 7 Garancite ligjore

Investimet dhe veprimtaria Shoqërisë së thjeshtë "AXTA TECHNOLOGY" gëzojnë mbrojtjen e shtetit Shqiptar, i cili krijon të njëjtat kushte si për subjektet shqiptare ashtu edhe ato të huaja.

Neni 8 Deyrimet e anëtarëve

Anëtarët themelues kanë këto detyrime por pa u kufizuar vetëm tek këto:

- a. Të regjistrojnë Studion në QKB, si dhe të marrë lejen e ushtrimit të aktivitetit të veprimtarisë së tyre.
- b. Te derdhin kapitalin e nevojshëm për fillimin e aktivitetit të Shoqërisë.
- c. Të sigurojnë mjediset e nevojshme për fillimin e aktivitetit, infrastrukturen e nevojshme, etj.
- d. Të sigurojnë mundësitë e specializimit të pandërprerë të personelit ndihmës e asistentëve gjithnjë në funksion të rritjes së nivelit dhe cilësisë të veprimtarisë së ushtruar nga ana e shoqërisë.
- e. Të menaxhojnë marketingun dhe reklamën nëpërmjet mjeteve të ndryshme të informacionit.

Neni 9 Organet drejtuese të shoqërisë

Organet drejtuese të Studios janë:

Asambleja e Anëtarëve.

Administratori i Shoqërisë së thjeshtë "AXTA TECHNOLOGY" do të jetë z.Armand Trgaj. Mënyra e veprimtarisë së tyre është përcaktuar në Statutin e Shoqërisë.

Neni 10 Punësimi

Për ushtrimin e veprimtarisë së kësaj shoqërie mund të punësohen me kohë të plotë ose të pjesshme punonjës sipas nevojave të aktivitetit.

Neni 11
Sekreti tregtar

Anëtarët themelues si dhe të gjithë anëtarët që do të pranohen si të tillë pranë "AXTA TECHNOLOGY" duke përfshirë edhe bashkëpunëtorët e saj detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë së thjeshtë "AXTA TECHNOLOGY".

Të punësuarit dhe të ngarkuarit me menaxhimin e Studios mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërisë së thjeshtë "AXTA TECHNOLOGY" për dëmet që i janë shkaktuar për faje të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

7

Neni 12
Partneriteti me palë të treta

Anëtarët Themelues mund të vendosin në mbledhjen e Asamblesë për pjesmarrjen në Shoqëri të tjera të tjera si brenda ashtu edhe jashtë vendit si dhe për pjesmarrjen e tyre në shoqëri të tjera tregtare në cilësinë e bashkortakëve apo të aksionerëve.

Neni 13
Mbarimi i Shoqërisë

Shoqëria e thjeshtë "AXTA TECHNOLOGY" do të funksionoj me një afat kohor të pa kufizuar. Afati i fillimit të veprimtarisë fillon mbas regjistrimit të Studios në Regjistrin QKB. Shoqëria mbaron me marrëveshje të anëtarëve, ose me largimin e dy anëtarëve. Me mbarimin e Shoqërisë përcaktohen dhe të drejtat e përdorimit të logos dhe emrit. Çdo anëtar ka të drejtë të largohet nga Shoqëria në cdo kohë. Pas largimit anëtari ka të drejtë të ushtroj të njëjtën veprimtari, por nuk mund të përdorë emrin, logon dhe e-mailin e Shoqërisë.

Neni 14
Mosmarrveshjet

14.1. Veprimtaria e Shoqërisë bazohet në normat e kësaj Kontrate Themelimi, Statutit të Shoqërisë, si dhe Legjislacionit Shqiptar në fuqi.

14.2. Themeluesit e saj mbajnë përgjegjësi në raport me kuotat vetëm për detyrimet që krijon Shoqëria e thjeshtë "AXTA TECHNOLOGY".

14.3. Mosmarrveshjet për themelimin e Shoqërisë së thjeshtë "AXTA TECHNOLOGY" do të zgjidhen nga vete anëtarët themelues me mirëkuptim, dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen nga gjykata kompetente. Gjykata kompetente për zgjidhjen e mosmarrveshjeve është Gjykata e Rrethit Durrës.

Neni 15
Te drejtat e lidhura me emërin e shoqëris

Te gjitha te drejtat dhe detyrimet që burojnë nga kontratat dhe marrveshjet e lidhura ndërmjet shoqëris dhe palëve të treat janë ekskluzivitet I shoqëris e cila ka detyrimin ti përmbush ato, edhe në rast largimit të njerit prej ortakeve.

Neni 16
Njoftimi

Ç' do njoftim zyrtar i kërkuar apo i autorizuar për t'u shperndarë, përvec rasteve kur përcaktohet ndryshe, duhet të bëhet me leter të postuar në adresën e studios ligjore që asiston Shoqërinë e thjeshtë "AXTA TECHNOLOGY" në adresën e mëposhtme: "Studio Ligjore "Tragaj&Associates" Lagja nr 2, Rr "Aleksandër Goga" pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Durrës, Albania zip code 2001.". Gjithashtu si mjete komunikimi jo zyrtare mund të shërbejnë adresa e postës elektronike: axtatech@gmail.com dhe nr cel: 00355692060909.


8

Neni 17
Dispozitë kalimtare


Për regjistrimin e shoqërisë në QKR ngarkohet Armand Tragaj.

ANËTARET THEMELUES

Armand Tragaj



Xhesida Tragaj



Artur Canaliu

